

Projekt-MARRËVESHJE TIP
PËR ANËTARËSIMIN NË KOMUNITETIN E ENERGJISË SË RINOVUESHME

Kjo Marrëveshje lidhet ndërmjet:

Komunitetit të Energjisë së Rinovueshme _____, i regjistruar pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE), me nr. regjistrimi _____, NUIS _____, me seli në _____, përfaqësuar nga _____, në vijim **“KER”**; dhe

Z./Znj./Subjektit _____, me NID/NUIS _____, me adresë _____, me pikë matjeje nr. _____, në vijim **“Anëtari”**.
KER dhe Anëtari, së bashku, quhen **“Palët”**.

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje përcakton kushtet e anëtarësimit të Anëtarit në KER, si dhe të drejtat dhe detyrimet e Palëve lidhur me pjesëmarrjen në aktivitetet e komunitetit, që përfshijnë prodhimin, konsumimin, depozitimin, ndarjen dhe, sipas rastit, shitjen e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.
2. Kjo Marrëveshje zbatohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, aktet rregullatore të ERE-s, Kodet e RRjetit si dhe Rregullat e tregut të energjisë elektrike.
3. Anëtarësimi në KER nuk zëvendëson kontratën e furnizimit me energji elektrike, kontratën e lidhjes me rrjetin apo marrëdhënie të tjera të detyrueshme sipas legjislacionit.

Neni 2

Parimet e anëtarësimit

1. Anëtarësimi në KER është i hapur dhe vullnetar, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe statuti i KER.
2. Anëtari nuk humbet, për shkak të anëtarësimit në KER, të drejtat dhe detyrimet që gëzon si klient fundor i energjisë elektrike.
3. KER zbaton parimet e transparencës, mosdiskriminimit, trajtimit të drejtë dhe proporcionalitetit.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e Anëtarit

1. Anëtari ka të drejtë:
 - a) të marrë pjesë në aktivitetet e KER në përputhje me legjislacionin dhe statutin;

- b) të përfitojë nga energjia e rinovueshme e prodhuar dhe e ndarë në kuadër të KER, sipas rregullave të përcaktuara në statut;
- c) të informohet në mënyrë të qartë për mënyrën e prodhimit, ndarjes dhe administrimit të energjisë si dhe për çdo aktivitet të KER në një nga format e zgjedhura të komunikimit;
- ç) të informohet për kostot, tarifat dhe detyrimet financiare që lidhen me pjesëmarrjen në KER;
- d) të marrë informacion mbi të dhënat e prodhimit, konsumit dhe energjisë së ndarë që lidhen me pikën e tij të matjes;
- dh) të marrë pjesë në vendimmarrjen e KER sipas statutit;
- e) të paraqesë ankesa dhe të kërkojë informacion mbi mënyrën e trajtimit të tyre;
- ë) të largohet nga KER në përputhje me këtë Marrëveshje dhe kostot e dakordësuara të largimit të parakohshëm nëse ka;
- f) të vazhdojë të ushtrojë të drejtën për të zgjedhur furnizuesin, kur kjo e drejtë i njihet nga legjislacioni në fuqi.

2. Anëtari detyrohet:

- a) të respektojë legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregullat e KER;
- b) të sigurojë saktësinë e të dhënave të deklaruara gjatë anëtarësimit;
- c) të paguajë kontributet dhe detyrimet financiare të përcaktuara në mënyrë transparente dhe në përputhje me rregullat e KER;
- ç) të respektojë rregullat teknike dhe të sigurisë të sistemit elektrik;
- d) të mos ndërhyjë ose manipulojë pajisjet e matjes;
- dh) të njoftojë KER për ndryshimet e të dhënave që ndikojnë në pjesëmarrjen e tij në komunitet;
- e) të autorizojë, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, përpunimin e të dhënave të nevojshme për funksionimin e skemës së ndarjes së energjisë.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e KER

KER ka të drejtë:

- a) të organizojë prodhimin, konsumin, depozitimin, ndarjen dhe shitjen e energjisë së rinovueshme, në përputhje me legjislacionin;
- b) të organizojë marrëdhëniet me operatorët e rrjetit, furnizuesit, agregatorët dhe subjektet e tjera të tregut, sipas rolit që ushtron;
- c) të administrojë të dhënat e nevojshme për funksionimin e KER;
- ç) të mbledhë kontributet dhe detyrimet e përcaktuara në përputhje me këtë Marrëveshje dhe aktet e KER.

KER detyrohet:

- a) të trajtojë Anëtarët në mënyrë të drejtë, transparente dhe jodiskriminuese;
- b) të informojë Anëtarët për mënyrën e funksionimit të KER dhe për kostot që lidhen me të;
- c) të zbatojë rregullat e miratuara për ndarjen e energjisë;
- ç) të administrojë në mënyrë të saktë të dhënat e matjes dhe informacionin e Anëtarëve;
- d) të respektojë rregullat e tregut, të rrjetit dhe të balancimit që i zbatohen;
- dh) të trajtojë ankesat e Anëtarëve në mënyrë të paanshme dhe brenda afateve të përcaktuara në Nenin 11;
- e) të sigurojë që Anëtari të mos humbasë të drejtat që i takojnë si klient fundor.

Neni 5

Procedura e aplikimit për pjesëmarrje

1. Personi fizik ose juridik që kërkon të bëhet anëtar i Komunitetit të Energjisë së Rinovueshme paraqet kërkesën për anëtarësim pranë KER-it, duke plotësuar dhe nënshkruar Marrëveshjen Tip për Anëtarësimin në KER, sipas modelit të miratuar.
2. Kërkesa për anëtarësim paraqitet pranë organit përgjegjës të KER-it, në formë shkresore ose elektronike, dhe shoqërohet vetëm me dokumentacionin e nevojshëm për identifikimin e aplikantit dhe verifikimin e plotësimit të kushteve të anëtarësimit të përcaktuara në aktet e KER-it dhe legjislacionin në fuqi.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja e kërkesës, KER-i verifikon nëse kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur janë të plotë. Në rast se dokumentacioni është i paplotë, KER-i i kërkon aplikantit plotësimin e tij, duke përcaktuar qartë dokumentet ose të dhënat që mungojnë. Aplikanti ka një afat prej 5 (pesë) ditësh pune nga marrja e njoftimit për të plotësuar dokumentacionin.
4. Kur kërkesa dhe dokumentacioni janë të plotë, KER-i shqyrton kërkesën dhe verifikon përmbushjen e kushteve për anëtarësim. Shqyrtimi përfshin, sipas rastit, verifikimin e identitetit të aplikantit, pranimin e kushteve të Marrëveshjes Tip dhe përputhshmërinë e kërkesës me kriteret e përcaktuara për pjesëmarrjen në KER.
5. Vendimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës për anëtarësim merret nga organi kompetent i KER-it brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e paraqitjes së dokumentacionit të plotë.
6. Në rast të pranimin të kërkesës, KER-i njofton aplikantin për miratimin e anëtarësimit dhe regjistrin anëtarin në regjistrin e anëtarëve të KER-it. Anëtarësimi konsiderohet i përfunduar nga data e miratimit të kërkesës, përveç rasteve kur në Marrëveshjen Tip përcaktohet një datë tjetër.
7. Në rast refuzimi të kërkesës, KER-i njofton aplikantin me shkrim, duke përcaktuar arsyet e refuzimit dhe, kur është e mundur, masat që duhet të ndërmerren për plotësimin e kushteve të anëtarësimit.
8. Mosshqyrtimi i kërkesës brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni nuk sjell miratimin në heshtje të anëtarësimit, përveçse kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.
9. Procedura e aplikimit dhe e anëtarësimit në KER zbatohet mbi parimet e aksesit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës dhe nuk mund të vendosë kërkesa ose procedura që nuk lidhen drejtpërdrejt me plotësimin e kushteve të anëtarësimit.

Neni 6

Përgjegjësia për balancimin dhe disbalancat

1. KER është përgjegjëse financiarisht për disbalancat që shkakton në sistemin elektroenergjitik, në përputhje me rregullat e balancimit dhe të tregut të energjisë elektrike.
2. KER ushtron përgjegjësinë e balancimit vetë ose e delegon atë te një subjekt përgjegjës për balancimin, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e tregut.
3. Kostot e disbalancave që i atribuohen KER duhet të përballohen nga KER

4. Kostot e disbalancave të ngarkuara KER-it nga Operatori i Sistemit të Transmetimit u atribuohen anëtarëve të KER në përputhje me disbalancën individuale të secilit anëtar, sipas rregullave të balancimit në fuqi.

Neni 7

Matja dhe ndarja e energjisë

1. Energjia e prodhuar, konsumi dhe energjia e ndarë ndërmjet Anëtarëve përcaktohen mbi bazën e të dhënave të matjes të siguruara nga Operatori i rrjetit në përputhje me kodet e Rrjetit dhe aktete tjera rregullatore në fuqi.
2. KER zbaton metodologjinë e miratuar për ndarjen e energjisë dhe informon Anëtarin për mënyrën se si përcaktohet pjesa e energjisë që i atribuohet atij.
3. Ndarja e energjisë nuk përjashton aplikimin e tarifave të rrjetit, taksave, tatimeve dhe detyrimeve të tjera të përcaktuara nga legjislacioni.
4. Tarifat e transmetimit, shpërndarjes, aksesit dhe përdorimit të rrjetit, si dhe taksat, tarifat dhe detyrimet e tjera të përcaktuara nga legjislacioni ose nga organet kompetente, aplikohen pavarësisht anëtarësimit në KER dhe nuk konsiderohen si tarifa të vendosura nga KER.

Neni 8

Detyrimet financiare

1. Anëtari paguan vetëm tarifën, kontributet dhe kostot që janë përcaktuar paraprakisht në statut dhe në mënyrë transparente.
2. Çdo ndryshim në detyrimet financiare të Anëtarit i komunikohet paraprakisht por jo më vonë se 30 ditë përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve.
3. KER nuk mund t'i ngarkojë Anëtarit kosto që nuk kanë bazë në këtë Marrëveshje, statutin e KER, aktet rregullatore ose legjislacionin në fuqi.
KER-i nuk mund t'i ngarkojë Anëtarit detyrime, pagesa apo përgjegjësi të tjera përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në legjislacionin në fuqi dhe në marrëveshjen e lidhur ndërmjet palëve.

Neni 9

Kohëzgjatja dhe përfundimi i anëtarësimit

1. Marrëveshja lidhet për një periudhë të pacaktuar, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.
2. Anëtari ka të drejtë të largohet vullnetarisht nga KER me njoftim me shkrim të paktën 30 ditë kalendarike përpara datës së tërheqjes.
3. Tërheqja nga KER nuk mund të kushtëzohet me penalitete të pajustificuara ose disproporcionale.
4. Përfundimi i anëtarësimit nuk shuan detyrimet financiare të lindura përpara datës së përfundimit.
5. Jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi i anëtarit, në formën e pranuar të komunikimit mes palëve, KER kryen llogaritjen përfundimtare të detyrimeve dhe të drejtave financiare të Anëtarit. Këto detyrime shlyhen jo më vonë se 5 ditë nga lëshimi i faturës së mbylljes së detyrimeve nga KER.
6. Në rast se, pas daljes së Anëtarit nga KER-i, rezulton se njëra palë i detyrohet palës tjetër një shumë, pala debitore detyrohet ta shlyejë atë brenda **30 (tridhjetë) ditëve** nga data e daljes së Anëtarit nga KER-i

Neni 10

Zgjidhja e Marrëveshjes

Marrëveshja përfundon:

- a) me tërheqjen vullnetare të Anëtarit;
- b) me marrëveshje ndërmjet Palëve;
- c) kur Anëtari nuk përmbush më kushtet e marrëveshjes;
- ç) kur KER humbet statusin ose të drejtën për të ushtruar aktivitetin përkatës;
- d) në raste të tjera të përcaktuara nga legjislacioni.

Përpara përfundimit të anëtarësimit për shkak të shkeljes nga Anëtari, KER e njofton atë për shkeljen dhe i jep një afat të arsyeshëm për korrigjimin e saj, përveç rasteve kur shkelja është e tillë që kërkon ndërprerje të menjëhershme për arsye sigurie ose ligjore.

Neni 11

Trajtimi i ankesave

1. Anëtari ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë KER për çdo çështje që lidhet me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Ankesa paraqitet me shkrim ose në mënyrë elektronike dhe duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për identifikimin e çështjes.
3. KER konfirmon marrjen e ankesës dhe e shqyrton atë brenda afatit të përcaktuar nga legjislacioni dhe aktet rregullatore në fuqi por jo më vonë se 30 ditë nga data e regjistrimit.
4. Përgjigjja duhet të jetë e arsyetuar dhe t'i komunikohet Anëtarit në një mënyrë të aksesueshme.
5. Kur ankesa nuk zgjidhet në mënyrë të kënaqshme, Anëtari ka të drejtë t'u drejtohet mekanizmave të tjerë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe autoriteteve kompetente, sipas legjislacionit në fuqi. Në rastet kur mosmarrëveshja lidhet me marrëdhënien ndërmjet Komunitetit të Energjisë së Rinovueshme dhe operatorit të rrjetit, ajo zgjidhet nga ERE, në përputhje me rregulloren përkatëse për trajtimin e ankesave nga klientët dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë elektrike.
6. Paraqitja e një ankesë nuk mund të përdoret si shkak për diskriminim ose trajtim të pafavorshëm të Anëtarit.

Neni 12

Mbrojtja e të dhënave

KER përpunon të dhënat e Anëtarit vetëm në masën e nevojshme për administrimin e anëtarësimit, matjen dhe ndarjen e energjisë, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe funksionimin e KER, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 13

Dispozita përfundimtare

1. Çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje zbatohet në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
2. Pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje janë:
 - formulari i anëtarësimit;
 - të dhënat e pikës së matjes;
 - rregullat/metodologjia e ndarjes së energjisë;

- tabela e kontributeve dhe kostove;
 - rregullat e trajtimit të ankesave.
3. KER njofton Anëtarin paraprakisht për çdo ndryshim të kushteve të anëtarësimit që ndikon në mënyrë materiale në të drejtat, detyrimet ose kostot e tij. Në rast të një ndryshimi material, Anëtari ka të drejtë të përfundojë anëtarësimin pa penalitet, në përputhje me afatin e njoftimit të përcaktuar në këtë Marrëveshje.
 4. Marrëveshja nënshkruhet në dy kopje, nga një kopje për secilën Palë, me fuqi të njëjtë juridike, që hyjnë në fuqi në datën e nënshkrimit.

PËR KER

Emri:

Përfaqësuesi:

Funksioni:

Firma:

Data: //_____

ANËTARI

Emri/Emërtimi:

NID/NUIS:

Firma:

Data: //_____

